

## **STATISTIKA PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 21 QERSHOR 2015**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka si qëllim në vetvete jo vetëm realizimin me sukses dhe në kohë i detyrave të ngarkuara me ligj, por njëherazi do të synoj rritjen në maksimum të besimit të zgjedhësve dhe aktorëve dhe faktorëve të përfshirë në të në integritetin e procesit.

1-Në kuadër të transperencës KQZ, është prezente në takimin e punës që zhvillohet çdo muaj me EWG dhe në këtë fazë të procesit në takime 2 javore, ku raporton për veprimtarinë e saj, praktikë pune kjo tashmë të konsoliduar.

2-KQZ ka miratuar aktet nënligjore brenda afateve kohore të parashikuara në Planin Orientues të Veprimeve, i cili përbën një dokument bazë dhe kornizë ligjore, për veprimtarinë e saj. Aktet me karakter rregullativ të procesit të marë para zgjedhjeve, janë të miratuara me konsensusin e plotë të anëtarësisë së KQZ-së.

3- Numri gjithsej i anëtarëve të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor (KZAZ) është 720. Seicila prej 90 KZAZ-ve ka në përbërje të vet 8 anëtarë, ku njeri prej tyre është sekretari i KZAZ-së pa të drejtë vote.

- ✚ Nga 270 propozime për anëtare të KZAZ-ve, të paraqitura nga Partia Socialiste dhe të emëruar nga KQZ-ja, 97 prej tyre i përkasin gjinise femerore, ne përqindje rreth 38%,
- ✚ Nga 270 propozimi për anëtare të KZAZ-ve, të paraqitura nga Partia Demokratike dhe të emëruar nga KQZ-ja, 90 prej tyre i përkasin gjinise femerore, ne përqindje rreth 37%,
- ✚ Nga 720 të emëruarit mbi bazën e propozimit të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike, Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet dhe Partia Republikane, 208 prej tyre kanë eksperiencë të mëparshme zgjedhore.
- ✚ Deri në momentin e raportimit kemi lirim zëvendësim komisionerësh nga partitë politike që i kanë propozuar ato, megjithë thirrjen e vazhdueshme të Kryetares së KQZ-se, për të ndaluar këtë fenomen aspak pozitiv në punën e KZAZ-ve.

4-Numri gjithsej i anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit (KQV) deri më sot është 37086 ku secila prej QV-ve ka në përbërje të vet 7 anëtarë, ku njeri prej tyre është sekretari i QV-së me të drejtë vote.

5-Numri gjithsej i anëtarëve të grupeve të numërimit të votave (GNV) duhet të jetë 3520, ku secila prej grupeve të numërimit do të ketë në përbërje të vet 4 anëtarë.

- ✚ Grupe numerimi të votave që do të ngrihen në 90 KZAZ-të e vendit- 880 (tavolina numërimi 440).

6-Numri gjithsej i anetareve te komisioneve zgjedhore te niveleve te dyta dhe te treta (KZAZ, KQV, dhe Grupeve te Numërimit të Votave) është 41.326,

- ✚ Nga 270 propozime për anëtarë të KZAZ-ve, të paraqitura nga Partia Socialiste dhe të emëruar nga KQZ-ja, 97 prej tyre i përkasin gjinise femerore, ne perqindje rreth 38%,

- ✚ Nga 270 propozimi për anëtarë të KZAZ-ve, te paraqitura nga Partia Demokratike dhe të emëruar nga KQZ-ja, 90 prej tyre i perkasin gjinise femerore, ne perqindje rreth 37%,

- ✚ Nga 720 të emëruarit mbi bazën e propozimit të Partisë Socialise, Partisë Demokratike, Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Republikane, 208 prej tyre kane eksperiencia te meparshme zgjedhore.

- ✚ Edhe për keto zgjedhje vazhdon odiseja e lirim zëvendësim anëtarë të komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë nga partitë politike që i kanë propozuar megjithë thirjen e vazhdueshme nga KQZ-ja, per te ndaluar kete fenomen megjithse ligjor, aspak pozitiv ne punën e KZAZ-ve.

- ✚ Nga konstituimi i KZAZ-ve, dhe deri ne fund te muajit maj, jane bere, mbi bazen e propozimeve te partive politike, lirime emerime komisioneresh, respektivisht si me poshte:

PS - muaji prill, 16 zevendesime - muaji maj 43 zevendesime

PD - muaji prill, 15 zevendesime - muaji maj 29 zevendesime

LSI - muaji maj 7 zevendesime

PR - muaji prill, 6 zevendesime - muaji maj 13 zevendesime

Ne total, 129 zevendesime.

7-Ndryshimet e Kodit Zgjedhor, të marsit 2015, janë të prekshme për zgjedhjet vendore 2015, konkretisht:

- 1) Në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore kanë kandiduar për anëtarë këshilli gjithsej 36 251, nga të cilët 17 887 ose 49,34% janë femra, dhe 18 364 ose 50,66% janë meshkuj.
- 2) Për kryetar bashkie, 16 kandidatë ose 9.94% janë femra dhe 145 kandidatë ose 90.06 % janë meshkuj.

Shifrat e dyta tregojnë qartazi se sfida të tjera janë për tu përballur në të ardhmen, në mënyrë që barazia gjinore të jetë e plotë, për të gjithë organet e zgjedhura.

8-Për këto zgjedhje janë regjistruar 63 parti politike dhe 2 koalicione zgjedhore. 9 janë partitë politike që konkurojnë më vete jashtë koalicioneve zgjedhore.

9-Numri gjithsej i kandidatëve që konkurojnë për kryetar në 61 bashkitë e vendit është 160, nga të cilët 120 prej tyre janë prozuar nga 2 koalicionet zgjedhore, 25 prej tyre nga parti politike jashtë koalicioneve dhe 15 prej tyre janë kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit e zonës zgjedhore përkatëse, ndërsa numri i kandidatëve të mbështetur nga zgjedhësit që konkurojnë për anëtarë në këshillat bashkiakë është 12.

10-Nga përpunimi i të dhënave, rezulton se në rang vendi janë gjithsej **3.369.393** zgjedhës. Bazuar në urdhërimet e Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015, sasia e fletëve të votimit që duhet të prodhohet duke shtuar 2-përqindëshin mbi numrin e zgjedhësve, 67.388, është **3.436.781** fletë votimi gjithsej.

11- Shtetasit 100 vjeçar që kanë mbushur moshën 100 vjec deri në ditën e zgjedhjeve janë 978, nga të cilët sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor vetëm 310 kanë bërë kërkesë për tu regjistruar në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë.

12-Numri i qendrave të votimit gjithsej 5298 nga të cilat, qendra votimi në ambiente private 432 të miratuara nga KQZ. QV te posaçme janë 20.

13-Bashkia Tiranë ka jo vetëm numrin më të madh të zgjedhësve-609.473, por dhe numrin e QV- 888, si dhe numrin e ZAZ- 13,

14-Bashkia Pustec ka numrin më të vogël të zgjedhësve 4280 dhe numrin më të vogël 8,të QV-ve

15-KQZ, bëri pjesë të administratës zgjedhore, persona nga PAK, si specialistë pranë zyrave rajonale zgjedhore në 12 qarqet e vendit, **me bindje** se puna gjithsecilit prej tyre do të jetë kontribut dhe ndihmë e madhe për t'i ardhur në ndihmë çdo zgjedhësi me aftësi të kufizuar për problematika të ndryshme që mund të përshfaqen.

16-KQZ ka punësuar në administratën e saj për këto zgjedhje një person nga target grupi i personave me aftësi të kufizuar dhe 1 person nga komuniteti rom.

17-Gjithashtu, persona PAK, do të angazhohen pranë pikave të informimit të zgjedhësve, që do të ngrihen në 12 qytete, qendër qarku.

18-KQZ, në kuadër të përgatitjes së infrastrukturës zgjedhore, planifikoi edhe mjetet ndihmëse për zgjedhësit me aftësi të kufizuar, të cilat do t'i dërgojë në 2800 QV (ku ata figurojnë të regjistruar në listën e zgjedhësve) në mënyrë që zgjedhësit e verbër të votojnë me maska me shkrimin brail, "shablloni".

19-Për sensibilizimin dhe informimin e zgjedhësve PAK, të gjithë spotet televizive, qofshin edukues, informues apo sensibilizues, do të jenë të përshtatur në gjuhën e shenjave;

20-Përmirësimi i teknologjisë së sistemit aktual do të konsistojë në mundësinë si të KQZ-së, ashtu edhe të subjekteve politike të interesuara që të kenë akses të personalizuar në sistemin e sigurisë me anë të kamerave të ambienteve ku mbahen Kuditë me fletët e votimit dhe BMZ-të (Baza Materiale Zgjedhore).

21-Në KQZ janë depozituar gjithsej 22 kërkesa ankimore kundër vendimeve të KZAZ-së, për rregjistrimin e kandidatëve për këshillin dhe rregjistrimin e kandidatëve për kryetar, të cilat janë shqyrtuar dhe janë marre vendimet perkatëse brenda afateve kohore nga KQZ-ja.

Në Kolegjin Zgjedhor janë paraqitur 14 kërkesa ankimore kundër vendimeve të KQZ nga subjekte zgjedhore, nga të cilat 4 janë pushuar, 5 janë pranuar dhe 5 janë rrëzuar.

22-Gjithsej janë akredituar **332 vëzhgues** nga të cilët **310 vëzhgues afatgjatë** (34 vëzhgues afatgjatë dhe 28 përkthyes të misionit të ODHIR-it, 17 vëzhgues afatgjatë nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendore (KVV) dhe 6 vëzhgues afatgjatë nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI), 2 vëzhgues afatgjatë nga delegacioni i BE ,104 nga Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qendrueshme (KZLNDQ), 119 vëzhgues afatgjatë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) si dhe **22 vëzhgues afatshkurter** nga të cilët 11 vëzhgues të (PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), 2 nga OSBE-Kosove, 2 vëzhgues afatshkurter të D4D, 1 vëzhgues afatshkurter i KQZ Letoni si dhe 6 vëzhgues afatshkurter KDI (Kosovo Democratic Institute)

23-Në periudhën parazgjedhore KQZ, duke besuar në tërësinë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të tij me strukturat shtetërore, shoqërinë civile dhe të gjithë aktorët e tjerë që kontribuojnë në realizimin e procesit zgjedhor, sipas standarteve ndërkombetare ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera :

- ✚ me Këshillin e Ministrave,
- ✚ me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
- ✚ me Autoritetin e Mediave Audiovizive, për monitorimin e fushatës së zgjedhjeve,
- ✚ me Prokurorinë e Përgjithshme, në kuadër të eliminimit të praktikave negative dhe identifikimin e shkeljeve penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

